VENDIM
Nr. 285, datë 18.12.2024

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË FILLUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s ME NR. 79, DATË 2.5.2024, "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FTL SHA PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË DRAGOBIA ENERGY SHPK"

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 20, germat "a" dhe "ë", nenit 24, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 23 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; neneve 11 dhe 12, të "Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016 dhe "Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 2546 prot., datë 13.12.2024, "Mbi përfundimin e procedurën së filluar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 79, datë 2.5.2024 'Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë Dragobia Energy sh.p.k.'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 79, datë 2.5.2024, "Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë "Dragobia Energy" sh.p.k. vendosi:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë "Dragobia Energy" sh.p.k. duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me "Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- ERE, në vijim me shkresën nr. 371/27 prot., datë 7.5.2024, ka njoftuar palët për këtë vendimmarrje dhe me shkresën nr. 1455 prot., datë 3.6.2024, me lëndë "Kërkesë për vënie në dispozicion dokumentacioni" i ka kërkuar shoqërive FTL sh.a., OST sh.a. dhe "Dragobia Energji" sh.p.k. që të depozitojnë në ERE çdo dokumentacion që vlerësojnë të nevojshëm për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje.

- ERE organizoi disa seanca dëgjimore për të zgjidhur mosmarrëveshjen ndërmjet FTL sh.a. dhe "Dragobia Energy" sh.p.k., mbi pretendimet e FTL-së për vonesën në dorëzimin e planit të prodhimit për vitin 2024. Në seancën e **21.6.2024**, ERE njoftoi palët për trajtimin e çështjes. FTL sh.a., përmes shkresës nr. **3595/12 prot., datë 11.6.2024,** theksoi qëndrimin e saj të mëparshëm, duke e konsideruar vonesën shkelje të nenit 5 të kontratës. Në seancën e datës **11.7.2024**, u kërkua që shoqëria "**Dragobia Energy" sh.p.k.** të paraqiste prova mbi dërgimin e planit brenda afatit kontraktor. Gjatë seancës së datës **15.7.2024**, shoqëria pranoi se plani ishte dorëzuar jashtë afatit më datë **11.12.2023**, por argumentoi se kjo vonesë nuk kishte ndikuar në realizimin e detyrimeve. Shoqëria deklaroi se duke filluar nga data **25.6.2024**, kishte lëvruar të gjithë prodhimin e hidrocentralit drejt FTL-së dhe angazhohej ta bënte këtë deri në fund të vitit 2024.

- ERE, me shkresën nr. 371/34 prot., datë 30.7.2024 i është drejtuar Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike-Alpex sh.a. dhe me shkresën nr. 371/33 prot., datë 30.7.2024 i është drejtuar shoqërisë

Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. me të njëjtën kërkesë, duke i kërkuar informacion nëse shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. ka tregtuar energji elektrike në tregun e një dite më parë për periudhën duke filluar në datën 15 korrik 2024 e në vijim. Ndërsa me shkresën nr. 371/36 prot., datë 1.8.2024 i është drejtuar Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a. duke i kërkuar informacion nëse shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. ka tregtuar të gjithë sasinë e energjisë elektrike në FTL sh.a., duke filluar nga data 15 korrik 2024 e në vijim.

- Shoqëria Alpex sh.a. me shkresën nr. 268/1 prot., datë 31.7.2024 i ka kthyer përgjigje shkresës së ERE-s me nr. 371/4 prot, datë 30.7.2024 se shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. nuk ka tregtuar energji në tregun e ditës në avancë të ALPEX sh.a. nga data 15.7.2024 deri më datën 31.7.2024.

- OST sh.a. me shkresën nr. 2096/8 prot., datë 2.8.2024 i ka kthyer përgjigje shkresës së ERE-s me nr. 371/4 prot, datë 30.7.2024 se shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. ka bërë nominime në platformën e OST sh.a., për kontrata bilaterale për periudhën 15 Korrik - 31 Korrik.

FTL sh.a. me shkresën nr. 3595/20 prot., datë 8.8.2024 i ka kthyer përgjigje shkresës së ERE-s me nr. 371/4 prot., datë 30.7.2024 për sasinë orare/ditore të energjisë elektrike të nominuar midis shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë"sh.a. dhe shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k.

- Me shkresën nr. **107/18 prot., datë 19.7.2024**, shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. kërkoi përfundimin e procedurës, duke argumentuar se objekti i mosmarrëveshjes ka rënë, pasi detyrimet janë përmbushur plotësisht dhe fakti mund të vërtetohet nga OST sh.a. dhe ALPEX sh.a.

- Lidhur me sa dokumentuar nga palët, nga shoqëria FTL sh.a. dhe shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k., vlerësohet se energjia e nominuar për periudhën 15 korrik -31 korrik 2024 nga shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. për FTL sh.a. përkon e njëjtë me energjinë e nominuar në Platformën e OST sh.a.

- Në vijim, ERE me shkresën nr. 371/40 prot., datë 17.10.2024, i është drejtuar FTL sh.a., duke kërkuar që kjo e fundit të dorëzonte qëndrimin e saj përfundimtar mbi mosmarrëveshjen. FTL sh.a., me shkresën nr. 3595/22 prot., datë 6.11.2024, e protokolluar në ERE me nr. 371/41 prot., datë 6.11.2024, ka kthyer përgjigje, duke deklaruar se mban të njëjtin qëndrim siç është parashtruar në dokumentacionin e dorëzuar më parë, përkatësisht në shkresën nr. 3595/17 prot., datë 15.7.2024.

- Në përfundim të shqyrtimit të procedurës së hapur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 79, datë 2.5.2024, mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë "Dragobia Energy" sh.p.k., dhe duke marrë në konsideratë gjithë dokumentacionin dhe provat e dorëzuara, seancat dëgjimore të zhvilluara, përgjigjet nga OST sh.a., ALPEX sh.a., si dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në kontratën përkatëse, vlerësojmë përfundimin e procedurës për shkak se objekti i saj ka rënë. Në mbështetje të nenit 90, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë": "*Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.*"

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 79, datë 2.5.2024, "Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë 'Dragobia Energy' sh.p.k.".

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë FTL sh.a. dhe "Dragobia Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti